



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRANAK LIPLJANE

**P.nr.551/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–DEGA NË LIPJAN**, nga gjyqtari Avdirrahman Gashi, me zyrtaren ligjore Nexhmije Ahmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurës B. V. nga I. Rr.”K.”, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.7626/2015 të dt.02.08.2016, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.24.04.2018, në prezencën e prokurorit të shtetit B. I., dhe të pandehurit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpallë këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurës:

**B. V.**, e bija e Xh. dhe R., e vajzërisë B. e lindur më *data e lindjes...*, në K., kurse jeton në rr.”K.”, pa nr. B., me nr. personal *numri personal...*, shqiptare, shtetase e Republikë së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datën 16.12.2015, rreth orës 19:45, në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj, e pandehura ka shkel Ligjin për Siguri në Komunikacionin Rrugor, në atë mënyrë që duhet drejtuar automjetin e tipit “Wv Jetta”, me ngjyrë të gjelbërtë, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, nga pakujdesia duke menduar me mendje lehtësi se deri të aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar kumunikaconin dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve të automjetit kushteve të krijuar në kumunukacion, ku e njëjta edhe përkundër që ka qenë duke lëvizur në rrugë kanë qenë me grica dhe si pasoj e kësaj duke kalur në shiritin e kundërt qarkullues e godet automjetin e tipit “Audi A8”, me ngjyr hiri me tabela regjistrimit *numri i targës...*, të cilin e drejtonte L. K., me ç’rast përveq dëmeve materjale në automjetin e tij, dëmtime të lehta trupore me dëmtime të përkoshme të shëndetit ka pësuar vet ngasësi i automjetit i dëmtuari L. K., në formë të ndrydhjes së indeve të buta te regjonit të kokës, qafës, kraharorit dhe regjonit i dorë,

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në baze të neneve, 1, 2, 4, 6, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-se, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me,

**DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej **150-€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë konform nenit 46 par 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgimi do ti llogaritet shuma prej 20-€.

**DETYROHET** i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve procedurë ti paguajës shumën prej 60.88-€, dhe në emër të shpenzimeve për pasushallin gjyqësor shumën prej 20.00-€, si dhe dhe shumën prej 30.-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari L. K. nga fsh. G. e U., K Lipjani, udhëzohen që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt civile gjyqësore.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj, PP.II.nr.7626/15 të dt.02.08.2016, e ka akuzuar të pandehurën Betime Visoqa, për shkak të veprës penale penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar përfaqësuesi i Prokurorisë ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se pranimi i tillë është i mbështetur në dispozitat ligjore, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit, si dhe me rastin e matjes së dënimit kësaj gjykate i ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga i pandehuri.

E pandehuri në shqyrtimin fillestar, e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, respektivisht për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe njëkohësisht nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë ngase është e moshës së re, dhe mbajtëse e 1 fehmijë hera e parë që bie ndesh me ligjin, si dhe gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurën, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale, se e njëjta është mbajtëse e 1 femijës, e moshës së re, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale apo te ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi, dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 450 par. 2 pika 2.1 dhe pika 2.6 të KPPK-së, ku në këto shpenzime janë llogaritur shuma prej 20-€, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shuma prej 60.88.-€ në emër të ekspertizës së komunikacionit si dhe shumen prej 30.-€ për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike gjykata e bazoi konform nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.551/16, me dt.24.04.2018**

**Sekretarja juridike**

Nexhmije Ahemi

**GJYQTARI**

Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.